



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 28 Prill 2022

Nr: 151

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN E DENONCIMIT TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE “PARTIA
DEMOKRATIKE” DHE “LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM”, NDAJ
BASHKISË DURRËS, PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE NË KUADËR TË
FUSHATËS ZGJEDHORE, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR
BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022**

Sot më datë 28 Prill 2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim në seancë dëgjimore denoncimin që u përket:

Kërkues: Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim

Objekti: Miratim vendimesh nga Bashkia Durrës, për miratimin e akteve nënligjore në kundërshtim me kufizimet e Kodit Zgjedhor

Ndaj: Bashkisë Durrës

Baza ligjore: Nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe ‘n”, pika 2 dhe 63, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe



Data: 28 Prill 2022

Nr. 151

“Për Për shqyrtimin e denoncimit të subjekteve zgjedhore “Partia Demokratike” dhe “Lëvizja Socialiste për Integrim”, ndaj Bashkisë Durrës, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

V Ë R E N:

I. Vlerësimi paraprak

1. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, gjatë mbledhjes së datës 02.02.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është raportuar një denoncim nga subjektet zgjedhore “Partia Demokratike” dhe “Lëvizja Socialiste për Integrim”, ku pretendohet se: *“Bashkia Durrës ka miratuar vendime për miratimin e listave për 526 familje që përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit, për ndërtesat e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019, që variojnë nga 100.000 (njëqind mijë) deri në 500.000 (pesëqind mijë) lekë. Ka dyshime të arsyeshme se këto grante/fonde janë përdorur për qëllime elektorale dhe zgjedhore, për shkak se po shpërndahen në prag të zgjedhjeve të pjesëshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”*. Sipas denoncuesve aktet e miratuara nga ana e bashkisë Durrës bien në kundërshtim me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe me parashikimet e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:
 - dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
 - f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
 - n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.
3. Referuar nenit 82, e vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, KQZ çmon se të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

4. Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.
5. Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, çmon të vijojë procedurën administrative ndaj bashkisë Durrës, për të cilën atribuohen veprimtari administrative, që vijnë në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

II. Rrethanat e faktit

6. Në denoncimin e raportuar pretendohet se Bashkia Durrës, në kundërshtim me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në KQZ, ka miratuar akte të cilat parashikojnë kalimin e fondeve apo granteve në favor të disa familjeve të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet shkresës nr. 502 prot., datë 03.02.2022, me lëndë “Kërkesë për informacion” i ka kërkuar Bashkisë Durrës informacion sqarues në lidhje me pretendimet e ngritura nga pala denoncuese dhe vendimmarrjen e tyre. Nëpërmjet shkresës nr. 1247/1 prot., datë 09.02.2022, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 502/1 prot., datë 14.02.2022, Bashkia Durrës pretendon se:
 - Këshilli i Ministrave, nëpërmjet vendimit nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019 dhe vendimit nr. 904, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, ka sanksionuar faktin se institucionet publike janë të detyruara të marrin masa të jashtëzakonshme për përballimin e situatës së tërmetit të datës 26 Nëntor 2019, duke përcaktuar në secilin prej akteve të mësipërme procedurën, institucionet dhe kategoritë përfituese nga fondet e rindërtimit.
 - Bashkia Durrës ka vijuar procedurën për procesin e rindërtimit pa ndërprerje dhe konform fondeve të miratuara nga Këshilli i Ministrave.
 - Rendi i mbledhjes së datës 28.01.2022, të Këshillit Bashkiak Durrës është njoftuar tek

anëtarët në datën 13.01.2022, ndërsa data e zgjedhjeve të pjesshme është dekretuar në datën 20.01.2022.

- Vendimi nr. 11, datë 28.01.2022 “Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare, sipas listës së trembëdhjetë me subjektet përfitues të programit të grantit për rikonstruksionin e banesave të dëmtuara si pasojë e dëmeve shkaktuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019”, pasqyron subjektet që plotësojnë kriteret ligjore për të vazhduar hapat e mëtejshme në procesin e rindërtimit, ndërsa kalimi i grantit do të kryhet vetëm pas përmbushjes së kërkesave ligjore.
7. Sipas kërkesave të denoncuesit të kryera në mbledhjen e datës 14.02.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nëpërmjet shkresës nr. 881 prot., datë 14.02.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, i ka kërkuar Bashkisë Durrës ti vendosë në dispozicion:
- njoftimin e sekretariatit të Këshillit Bashkiak Durrës për mbledhjen e datës 28.01.2022;
 - aktet e mbledhjes, që u janë vënë në dispozicion anëtarëve të Këshillit Bashkiak Durrës;
 - procesverbalin e mbledhjes se datës 28.01.2022;
 - vendimet nr. 2, 4, 11 dhe 12, datë 28.01.2022 të Këshillit Bashkiak Durrës.
8. Nëpërmjet shkresës nr. 882 prot., datë 14.02.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i ka kërkuar informacion Bashkisë Durrës dhe Zyrës së Gjendjes Civile Durrës, se sa prej anëtarëve të familjeve përfituese nga këto grante mund të ushtrojnë të drejtën për të votuar. Bashkia Durrës nëpërmjet shkresës nr. 1247/3 prot., datë 22.02.2022, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 1183 prot., datë 24.02.2022, ka dërguar informacionin e kërkuar nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nëpërmjet shkresës nr. 881 prot., datë 14.02.2022, duke vënë në dispozicion:
- njoftimin e sekretariatit të këshillit bashkiak Durrës për mbledhjen e datës 28.01.2022;
 - aktet e mbledhjes, që u janë vënë në dispozicion anëtarëve të Këshillit Bashkiak Durrës;
 - procesverbalin e mbledhjes se datës 28.01.2022;
 - vendimet nr. 2, 4, 11 dhe 12, datë 28.01.2022 të Këshillit Bashkiak Durrës.
9. Bashkia Durrës nëpërmjet shkresës nr. 1591/1 prot., datë 04.03.2022, protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 881/1 prot., datë 07.03.2022, ka konfirmuar numrin e votuesve, që do të ushtrojnë të drejtën për të votuar nga 526 familjet përfituese nga grantet.
10. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1199 prot., datë 24.02.2022, përcjell për njohje gjetjet e denoncimit të subjekteve zgjedhore Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim ndaj bashkisë Durrës, si dhe sipas përcaktimeve të nenit

2, të pikës 15, të vendimit nr. 9 datë 6.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, subjekti zgjedhor “Partia Demokratike”, “Lëvizja Socialiste për Integrim” dhe Bashkia Durrës, janë njoftuar për të paraqitur prapësimet në lidhje me denoncimin e sipërcituar.

11. Brenda afatit të përcaktuar Bashkia Durrës paraqiti prapësime në lidhje me denoncimin, subjektet zgjedhore Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim nuk paraqitën prapësime. Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1730 prot., datë 11.03.2022, bazuar në përcaktimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ka njoftuar palët për zhvillimin e seancës dëgjimore, më datë 15 Mars 2022, ora 11:30, me palë Partia Demokratike, Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Bashkia Durrës.
12. Në seancë dëgjimore u paraqitën palët në proces, subjekti zgjedhor “Partia Demokratike” me përfaqësues të tij z. Marash Logu si dhe z. Arben Isaku, me detyrë drejtor i drejtorisë ligjore në Bashkinë Durrës, i autorizuar nëpërmjet shkresës nr. 2350/1 prot. datë 15.03.2022 të Bashkisë Durrës, i administruar si dokument gjatë seancës dëgjimore.
13. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i kërkoi përfaqësuesit të subjektit zgjedhor “Partia Demokratike”, të parashtrojë pretendimet e tij në lidhje me denoncimin.

Pretendimet e palëve:

Në shpjegimet e tij z. Logu konfirmoi edhe njëherë denoncimin e bërë në seancë publike duke shtuar si provë të re, faktin se nga ana e Bashkisë Durrës, ka pasur shkelje flagrante të ligjit nr. 139/2015 në lidhje me procedurën e thirrjes së mbledhjes pasi mbledhja është njoftuar më datë 13 Janar por vetëm në datë 24 Janar anëtarët janë njohur me aktet dhe projektvendimet e mbledhjes. Projektvendimi i denoncuar nuk ka qënë i përfshirë në njoftimin e datës 24 Janar por është njoftuar dy ditë përpara mbledhjes, në një kohë që duhet të ishte njoftuar minimumi 5 (pesë) ditë përpara.

- Në pretendimet e tij përfaqësuesi i subjektit zgjedhor “Partia Demokratike”, shton se kjo nuk është e vetmja shkelje e Këshillit Bashkiak Durrës, pasi në të njëjtën ditë është miratuar dhe një vendim për dhënie ndihme ekonomike për 89 familje, gjithashtu është miratuar dhe një vendim tjetër me objekt dhënien e 21 bursave.

Në mbledhjen e datës 28 Janar Këshilli Bashkiak Durrës, ka miratuar dhënien e granteve të rindërtimit për 526 famije, ndihmë ekonomike për 89 familje dhe 21 bursa studimi për nxënës dhe student, të cilat qartazi janë dhënë për të ndikuar në zgjedhjet e datës 06 Mars 2022.

Z. Logu kërkon zgjerim të objektit të denoncimit për shkak se:

1. Në mbledhjen e datës 28 janar Bashkia Durrës ka miratuar grante për rindërtimin, ndihmën ekonomike si dhe bursa studimi.

2. Në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës është njoftuar në datë 22 shkurt 2022, një mbledhje e Këshillit Bashkiak Durrës për datën 25 shkurt 2022, ora 12:00, me dy pika njëra prej së cilës thotë për miratimin e familjeve përfituese nga fondi ndihmës ekonomike nga ku është miratuar vendimi për dhënien e ndihmës ekonomike për 90 familje nga të ardhurat e Bashkisë Durrës, futja në listën për përfitimin e ndihmës ekonomike të 6 familje dhe 20 familje nga fondi i caktuar prej 6% nga të ardhurat e bashkisë, pra që do të thotë që edhe nëse afati do të kishte nisur nga data 31 janar, mbledhja është zhvilluar në datë 25 shkurt vetëm disa ditë para zgjedhjeve.

Në përfundim të pretendimeve të tij z. Logu, kërkoj të vihet në dispozicion informacioni që mungon në lidhje me numrin e personave që votojnë në këtë listë prej 526 familjesh.

- Përfaqësuesi i Bashkisë Durrës, depozitoi në seancë dëgjimore prapësimet e tij me shkrim në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, duke i qëndruar shpjegimeve të dhëna me shkrim gjatë hetimit administrativ nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke pohuar edhe njëherë se bashkia Durrës ka respektuar vetem ligjin dhe nuk është përpara një shkelje pasi bashkia Durrës është në proces rindërtimi. Në lidhje me pretendimet e ngritura Bashkia Durrës ka vënë në dispozicion të gjitha shkresat e nevojshme. Përfaqësuesi ligjor i Bashkisë Durrës pretendon se në lidhje me ndihmën ekonomike nuk përbën shkelje përse kohë është e përcaktuar që më parë në buxhetin e Bashkisë Durrës, pasi është një ndihmë që jepet çdo muaj.
14. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në përfundim të pretendimeve të palëve kërkoj që brenda 3 (tre) ditëve bashkia Durrës, të sjellë informacion në lidhje me shpërndarjen e ndihmës ekonomike, kush përfiton si dhe pse përfiton si dhe informacion në lidhje me numrin e personave që votojnë në këtë listë prej 526 familjesh.
15. Në përfundim të afatit 60 (gjashtëdhjetë) ditor të shqyrtimit të këtij denoncimi, hetimi administrativ është ende i papërfunduar, për shkak të kompleksitetit të çështjes objekt shqyrtimi. Referuar nenit 7, të vendimit nr. 9, datë 09.04.2021, të Komisionit Rregullator “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 139, datë 01.04.2022 “Për zgjatjen e afatit të

shqyrtimit administrativ të denoncimit të subjekteve zgjedhore “Partia Demokratike” dhe “Lëvizja Socialiste për Integrim” për shkelje të parashikuar në nenin 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Durrës”, vendosi zgjatjen e afatit me 60 (gjashtëdhjetë) ditë të tjera.

16. Bashkia Durrës më datë 18.03.2022, nëpërmjet shkresës nr. 2350/2 prot., administruar me tonën nr. 1846 prot., datë 23.03.2022, vë në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sqarime lidhur me procedurën e miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Durrës, të listës së familjeve përfituese të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllokndihmën ekonomike deri 6% dhe fondi i ardhur nga Bashkia si dhe shkresën nr. 2350/3 prot., datë 18.03.2022, administruar me tonën nr. 1845 prot., datë 23.03.2022, nëpërmjet së cilës Bashkia Durrës vë në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeveve informacion mbi numrin e personave me të drejtë vote nga lista totale e miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 11, datë 28.01.2022, “Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare, sipas listës së trembëdhjetë me subjektet përfituese të programit të grantit për rikonstruksionin e banesave të dëmtuara si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019”.
17. Nëpërmjet shkresës nr. 1394 prot., datë 28.03.2022, shkresat e sipërcituara ju janë dërguar për njohje subjekteve zgjedhore denoncuese Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 2127 prot., datë 11.04.2022, bazuar në përcaktimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ka njoftuar palët zyrtarisht dhe në mënyrë elektronike për zhvillimin e seancës dëgjimore, më datë 13 Prill 2022, ora 13:00, me palë “Partia Demokratike”, “Lëvizja Socialiste për Integrim” dhe bashkia Durrës. Në seancë dëgjimore u paraqitën palët në proces, subjekti zgjedhor “Partia Demokratike” me përfaqësues të tij z. Marash Logu si dhe z. Arben Isaku, me detyrë drejtor i drejtorisë ligjore në Bashkinë Durrës.
18. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve filloi seancën dëgjimore duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur përfaqësuesit të subjektit zgjedhor “Partia Demokratike” dhe përfaqësuesit të bashkisë Durrës. Z.Logu në cilësinë e përfaqësuesit të subjektit zgjedhor “Partia Demokratike” deklaroi se, është vënë në dijeni mbi shkresat e depozituara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nga bashkia Durrës. Z. Logu pretendon se nëpërmjet këtyre shkresave është provuar dhe njëhërë se bashkia Durrës ka mundësuar shpërndarjen e ndihmave ekonomike, dhënien e bursave për studentet etj.

Përfaqësuesi i bashkisë Durrës depozitoi në seancë prapësimet përfundimtare duke deklaruar se, bashkia Durrës është një institucion që ofron shërbime, dhe procedurat e nisura janë vijueshmëria e proceduravë të rindërtimit dhe janë të kushtëzuara nga domosdoshmëria dhe nevoja për të bërë të mundur lehtësimin e pasojave nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2022.

19. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi dëgjoji palët në proces, përfundoi shqyrtimin në tërësi dhe hetimin administrativ duke kërkuar nga palët parashtrimin e konkluzioneve përfundimtare. Z.Logu në përfundim të procesit administrativ i qendroi pretendimeve të tij duke kërkuar marrjen e masave administrative ndaj bashkisë Durrës në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. Z.Isaku në përfundim të procesit administrativ duke trajtuar, analizuar dhe shqyrtuar me detaje faktet dhe atë që është relatuar në seancën e kaluar kërkoi pushimin e shqyrtimit pasi pretendimet e ngritura nga subjektet zgjedhor nuk qëndrojnë pasi vendimmarja pasi është një procedurë vijimësie pa ndërprerje, konform fondeve të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

III. Analiza ligjore

20. Në denoncimin e mësipërm, Këshilli Bashkiak Durrës në datën 28.01.2022, ka miratuar akte nënligjore nr. 2,4,11 dhe 12 datë 28.01.2022, nëpërmjet të cilave parashikohet kalimi i graveve për rikonstruksionin e banesave të rindërtuara; mbështetje ekonomike dhe sociale për kategoritë e caktuara; dhënien e bursave të studimit.
21. Specifikisht, në pikën 4, të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, parashikohet se ***“Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore.”***

Neni 3, pika 4, e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin

22. Qendror të Zgjedhjeve, parashikon se **“Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi i akteve ligjore ose nënligjore, ose nxjerrja e tyre me qëllim informimin e publikut në lidhje me vendimmarrjen e institucionit miratues në faqen e tij zyrtare, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensione, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, faljet e kamatvonesave, të gjobave, të detyrimeve tatimore e doganore vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore ose të epidemisë/pandemisë, apo ka si qëllim zbatimin e një detyrimi ligjor me karakter ndërkombëtar apo zbatimin e një vendim gjyqësor të formës së prerë”**.
23. Në qoftë se bëjmë leximin literal të nenit 91, pika 4, të Kodit Zgjedhor, **“deri në formimin e qeverisë së re”** duket se legjislatori e kufizon **“miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore, që parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara”** vetëm për zgjedhjet e përgjithshme për kuvend. Sa më sipër, në mungesë të një dispozite ndaluese, nxjerrja e kësaj kategorie aktesh për zgjedhjet vendore, qofshin këto dhe të pjesshme, nuk mund të jenë objekt shqyrtimi për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Bashkia Durrës nuk mund të procedohet për një akt administrativ, që në momentin kur është nxjerrë, nuk parashikohet nga Kodi Zgjedhor si shkelje administrative. Në këtë kuadër, miratimi i këtij akti administrativ prej të denoncuarit mbetet brenda parashikimeve të ligjit.
24. Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përfundon shqyrtimin administrativ për denoncimin e kryer nga Partia Demokratike dhe nga Lëvizja Socialiste për Integrim, pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se miratimi i aktit nënligjor nga ana e Bashkisë Durrës nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e ndalimeve të përcaktuara në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n”, pika 2, dhe nenet 91, 92, 171/1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin ,3 pika 2, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, dhe nenet 17, 18, 19 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative

V E N D O S I:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj bashkisë Durrës.
2. Moskonstatimin e shkeljes së dispozitave të ligjit nr. 10019, datë, 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 28 Prill 2022

Nr. 151

“Për Për shqyrtimin e denoncimit të subjekteve zgjedhore “Partia Demokratike” dhe “Lëvizja Socialiste për Integrim”, ndaj Bashkisë Durrës, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”